

RELACION TEKNIK

**Per projektin: "RIKONSTRUKSION I KANALIT TË LINGAJCES FAZA III
FSHATI RRAJCE", BASHKIA PRRENJAS.**

TE PERGJITHSHME

Erozioni i tokës përfaqeson një nga dukuritë shkatterimtare të reliefit tokësor, si nëpërmjet gërryerjes sipërfaqesore dhe asaj në thellësi. Veprimtaria relativisht e dukshme e erozionit ujor që vërehet kudo është e favorizuar nga mjaft faktorë si reliivi, përbërja gjeologjike, pjerrësia, veshja me bimësi, toka, klima etj.

KUSHTET KLIMATIKE

Të gjithë elementët kryesore klimatik, sidomos reshjet edhe temperaturat ndikojnë jo vetëm në mënyrë të drejtpërdrejtë por edhe në mënyrë të tërthortë në lindjen dhe zhvillimin e erozionit të tokës, prandaj dhe studimi i tyre ka rëndësi të veçantë si për raste kur duam të projektojmë masa për luftimin e gërryerjeve ashtu edhe në zbatimin e punimeve agro-silvoteknike. Një vëmëndje shumë e veçantë i është kushtuar jo vetëm sasisë së përgjithshme të reshjeve, e cila jep në përgjithsi idenë mbi lagështinë e një territori, por edhe shpërndarjen e tyre stiore e mujore. Theksojmë se ndikim të drejtpërdrejt në gëryerjen e tokës ka sidomos intensiteti i rënies së tyre, i cili ndikon jo vetëm në sasinë e përgjithshme të rrjedhjes por edhe në fuqinë gërryese të tyre.

TE DHENA PER HARTIMIN E PROJEKTIT

Vendi i ndertimit – Nj. A. Rrajce

Qellimi i ndertimit -- Permiresimi i infrastrukturies te kanalizimeve te ujrale te shiut dhe burimeve ujore te zones.

Hartimi i projektit eshte mbeshtetur si me poshte:

I- Gjendja aktuale e kanalit.

II--Detyra e projektimit dhene nga Bashkia Prrenjas.

III--Zhvillimi i projektit:

PER PROJEKTIN: "RIKONSTRUKSION I KANALIT TË LINGAJCES FAZA III FSHATI RRAJCE", BASHKIA PRRENJAS.

Renia e shirave te jashtezakonshme ka krijuar situate emergjente ne territorin e Bashkise Prrenjas per shkak te prurjeve te medha te inerteve ne kolektorin e Lingajces eshte rritur teper niveli i ketij kolektori duke u bere rrezik per permbytje te tokave buqesore perreth.Kjo situate eshte edhe per faktin se ne kete kolektor nuk eshte nderhyre prej vitesh me investime dhe kjo e ben edhe me te domosdoshem nderhyrjen ne kete veper me qellim rikonstruksionin e segmentit nga rruga kryesore deri tek shtepite e Hallidrit.

Ky kolektor mbledh ujrat e gjithe pellgut ujembledhes te Rrajces e te Sutanit, e per rrjedhoje ne kohe piku prurjet e ujit jane shume te medha e sjellin edhe sasi te medha inertesh. Per te minimizuar demin eshte e domosdoshme nderhyrja me investime duke kryer rikonstruksionin e ketij kanali per njje segment qe eshte me i rrezikuar e konkretisht segmenti nga rruga kryesore deri tek shtepite e Hallidrit.

Ne kete segment do te kryhen punime te karakterit sistemimi i argjinaturave, thellimi i shtratit, riparimi i shpateve te kolektorit etje.Ne te gjithe gjetesine materiali i germuar do te transportohet. Pas kryerjes se punimeve perqatitore gjithe kolektori do te betonohet ne gjatesine 248 ml, ku do te vendoset edhe hekur Φ -10 ne forme rrrjete dhe trashesia e betonit mbi 15 cm ndersa marka 16/20

Gjereria e kolektorit ne baze do te jete 3 ml dhe lartesia mbi 1.5 ml duke i dhene faqeve pjerresi natyrale. Ne kete menyre ky kolektor do te percjelle nje sasi me te madhe uji dhe ne menyre te sigurt pa shkaktuar gerryerje per gjate trupit te vet.

Me perfundimin e ketij investimi do te perfitojne fshatrat Rrajce, Sutaj, Urake dhe Prrenjas-fshat ku hiqet nga harta e rrezikut nje siperfaqe prej mbi 100 ha toke buqesore dhe nga ky investim perfitojne nje numer popullsie mbi 7000 banore. Realizimi i investimit nuk ka probleme te karakterit te pronesise pasi e gjithe prona eshte shteterore nen monitorimin e sektorit te Ujites dhe Kullimit prane Drejtorese se Bujqesise dhe Konsumatorit ne Bashkine Prrenjas.

Duke u nisur nga kerkesat e vazhdueshme dhe shqetesim te banoreve per te bere rikonstruksionin e kanalit, nga Bashkia Prrenjas, ky shqetesim eshte pare me perparesti dhe eshte vleresuar si emergjente rikonstruksioni i ketij kanali.

Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Aplikimit të Projekteve ka bere matje direkt ne terren dhe eshte hartuar projekti per rehabilitimin e kanalit.

Ne projekt jane parashikuar keto punime qe do te kryen:

- Pastrimi i kanalit nga dherat dhe mbetjet urbane.
- Prerja e pemeve ne kanal dhe pas kanalit.
- Trasportimi i materialeve te te dherave dhe te betonit ne vendin e caktuar.

Pasi te jene perfunduar keto punime do te behet betonimi i kanalit sipas preventivit te hartuar dhe profileve ku marka e betonit do te jetë C-25/30 per ti rezistuar temperaturave te ulta ne stinen e dimrit, pasi ne periudhen e dimrit temperaturat shkojne ne - disa grade nen zero te cilat krijojnë erozion dhe demtim te argjinaturave te kanaleve dhe te tokes.

3. PERZIERJA E BETONIT.

Perzierjet dhe llojet e ndryshme te betonit do te perfitoohen ne perpjestim me rregullat qe pefitojne fortesine e kerkuar.

Permbajtja e ujit ne beton duhet te kontrollohet rigorozisht dhe te mbahet ne minimumin e kerkuar per te perfituar nje beton te pershatshem e punimit qe do te kryhet.

Ne asnje rast nuk duhet qe raporti i ujit dhe çimentos te kaloje raportin uje/cimento 0.50%.

Shkalla e perzierjes te betonit percaktohet nga nje numer, i cili eshte fortlesia 28 ditore, qe tregon se betoni e ka fituar fortesine kerkuar (ose koinsistencen).

4. Preventivi i plete i zbatimit te punimeve i vleresuar me çmimet e tregut sot, ku perfshihen edhe taksat ne fuqi dhe tvsh 20%.

5. Konkluzione

Nga verifikimet ne vend dhe nga llogaritjet konkludojme se eshte e domosdoshme rikonstrukioneve i kanalit te qytetit. Ne projekt eshte dhe mos cenimi i pronave private.

➤ **Rekomandime**

- Me pare te filloje ndertimi i kantierit per grumbullimin e bazes materiale. Rekomandojme qe para se te filloje zbatimi i projektit te merret leja e ndertimit dhe leja tek pronaret e tokave .
- **Preventivi i vepres.**

Preventivi i punimeve bazuar Vendimit nr. 216, datë 13.4.2023, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”.

Preventivi i zbatimit te punimeve i vleresuar me cmimet e tregut sot dhe me struktura preventivi TVSH 20%.

Realizimi sipas projektit dhe ne afat i vepres ploteson me se miri nevojat per rehabilitimin e ketij kanali te banoreve te qytetit dhe realizimit te nje infrastrukturë bashkohore.

Punoi:
Equerem Karriqi

Gëzim Bitri

Olgert Alla

